



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 19.11.2024

Nr: 25

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 16, DATË 29.10.2024  
TË DEPOZITUAR NGA Z. VANGJEL TAVO**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.11.2024, me pjesëmarrjen e:

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**ANKUES:** Z. Vangjel Tavo

**OBJEKT:** 1. Kundërshtim i vendimit nr. 187, datë 09.10.2024 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

2. Shfuqizimin e pikës 1, gërma “b”, të vendimit nr. 187, datë 09.10.2024 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Data: 19.11.2024 Nr: 25  
Ora: 11:00



“Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 16, datë 29.10.2024 të depozituar nga z. Vangjel Tavo”

**BAZË LIGJORE:**

Nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

**VËREN:**

1. Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është administruar denoncimi me nr. 2 ID me denoncues Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK). Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike. Në funksion të fushatës elektorale, kandidati i Partisë Socialiste për kryetar të Bashkisë Himarë, z. Vangjel Tavo si dhe përfaqësues të kësaj partië, kanë zhvilluar në datën 01.08.2024, një takim elektor, në oborrin e shkollës së Mesme e Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh. Ky takim është postuar në faqen zyrtare Facebook nga kandidati.
2. Z. Vangjel Tavo depozitoi pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, u regjistrua në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 16 regj., datë 29.10.2024. Në këtë kërkesë ankimore ankuesi kundërshton vendimin nr. 187, datë 09.10.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke kërkuar shfuqizimin e pikës 1, gërma “b”, të vendimit të sipërcituar.
3. KAS-i caktoi me short anëtarin z. Ilirjan Rusmali si relator dhe vendosi zhvillimin e seancës paraprake në datën 19.11.2024, ora 11:00. Në seancë ishin të pranishëm anëtarët e KAS-it dhe administrata e KQZ-së.
4. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - Kërkesën ankimore nr. 16, datë 29.10.2024;
  - Kërkesën nr. 04, datë 15.11.2024, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
  - Vendimin nr. 187, datë 09.10.2024 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 2 ID nga Koalicionin Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024” , të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

**KAS-i konstaton:**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka marrë vendimin nr. 187, datë 09.10.2024, si hap procedural përmbyllës për hetimin administrativ ndaj z. Vangjel Tavo. Mbi këtë bazë KSHZ ka proceduar me kërkesën e tij nr. 04, datë 15.11.2024 për vendosje sanksioni administrativ, gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë ndaj z. Vangjel Tavo dhe 4 000 (katër mijë) lekë ndaj zj. Haide Dhuli, Drejtor i Shkollës së Mesme të Bashkuar “Qazim Pali”, Borsh.
2. Vendimi nr. 187, datë 09.10.2024 shpreh vetëm vullnetin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të vënë në lëvizje KAS-in me kërkesën për marrjen e masës administrative me gjobë. Ky vendim nuk sjell asnjë pasojë juridike dhe nuk cënon asnjë interes të palëve të prekura, sepse kompetenca për vendosje sanksioni administrativ është kompetencë e KAS-it.



3. Të drejtat e palëve të prekura, në rastet e procedimit me kërkesë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mbrohen vetëm duke marrë pjesë si palë në shqyrtimin administrativ që zhvillohet nga KAS-i, dhe jo me procedurë ankimore ndaj vendimit përmbyllës të Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 16, datë 29.10.2024, të paraqitur nga z. Vangjel Tavo.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi, bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 03.12.2024.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>